




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republie of Kosovo



NUMRI I DOKUMENTIT DHE KODI I IDENTIFIKIMIT
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0023418/25
Data 20-06-2025
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverballi i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 29.05.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, z. Ismet Aliu);
5. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: I nderuar kryetari i komunës, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 26 anëtar, mungojnë me arsye Kushtrim Dragaj, ndërsa mungojnë pa arsye Ragip Durmishi, Ilir Ejupi, Arjeta Rama dhe Nezir Ismajli.

-Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, nuk po e shohë drejtorin e bujqësisë, me qenë se edhe sot kemi pika pak për rend dite, kisha Propozua që me pas drejtorin e bujqësisë me na dhënë një lloje informate lidhjen me Thirrjet për aplikim për subvencione që e ka bërë kjo drejtori. Si këshilltar komunal dëshiroj me ditë përse janë dy thirrje që janë grande të njëjta vetëm sera 100m2 dallon prej njëra tjetrës, përse është kjo? Dhe për kur janë këto subvencione p.sh. Sera, jemi në fund të majit dhe deri sa të përfundon procedura kryhet qershori, pra a janë këto subvencione për këtë vit apo për vitin tjetër? Pra propozoj si pikë shtesë Informatë për drejtorin e bujqësisë lidhje me këto thirrje që i ka shpall?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, sa i përket çështjes që e ngrite z.Mehani besoj që është e nevojshme me sqarua këtë pjesë, po si ekzekutiv drejtorët ndonjëherë kanë punë dhe me lejen time kur jam unë këtu i liroj dhe dha përgjigje për çështjen që adresohen. Lidhje për thirrjen për subvencione ne e kemi fondin për bashkëfinancim dhe shpesh jemi në një situatë kur kemi partner dhe në këtë rast Islamik Relifin, dhe drejtoria për bujqësi në bazë të kërkesave të bujqve i ka parapa këto pajisje në dy thirrje. Dhe nuk ka nevojë me hy si pikë shtesë kjo informatë dhe në pyetjet parlamentare drejtori e jepe përgjigjen kësaj çështje nëse e parashtron si pyetje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Te pyetjet parlamentare nuk po e ekzagjerojnë krejt çështjen, pra ka nevojë edhe për nen pyetje tjera, unë mendoj që drejtori, drejtoria duhet edhe me i ndryshua edhe politikat, pra nuk po dua me i përmend keqpërdorimet, që njeri e ka marr pajisjen që kurrë se ka përdor edhe e ka shitë, krejt ato i dimë, po flasim përtej kritikes që duhet me bërë një debat edhe nuk i bënë dem

nëse e bëjmë një pikë edhe e trajtojmë bujqësinë në Skenderaj, se jo çdo herë mjete të njëjta, p.sh. me provua me farë gruri, pleh, me i subvencionua kafshët që janë të rrezikuara, sepse komunat tjera janë tu e bë këtë, edhe përse janë dy thirrje të njëjta?

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: z. Mehani këto kërkesa duhet me i adresua kur të votohet buxheti, dhe nga dëgjimet buxhetore, unë jam kanë edhe në kuvendin e Kosovës çdo gjë që me ka interesuar e kam ngrit në pyetjet parlamentare dhe kam marr përgjigje dhe të njëjtën mundesh me bë edhe ti, sepse është procedurë. Edhe donatorët i kanë kriteret e tyre, bile gjithmonë i kanë shumicën në komisione kur ti bëjnë vlerësimet në teren.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: z. Nura se di përse po e kursen drejtorin, unë e di që në projekt buxhet kam propozua që me i dhënë prioritet lumenjve, kanalizimeve dhe transportit publik dhe këto kërkesa nuk janë marr parasysh dhe nuk janë adresuar. Është e rëndësishme që me ndryshua politikat së qysh është tu funksionuar ky drejtor, dhe këtu të bëjmë një debat, dhe le të na bind aj që e ka mirë, me argumente, po mos e mbroj, se unë e di që ka dhënë mekanizma që kurrë se ka përdor, dhe i kanë bë telash se nuk kanë ditë me çka me i marr me qua të shpija, së ju kam drejtua prokurorisë për këto keqpërdorim. Dhe donatorëve mundesh me ja shënuar do kërkesa që janë risi për fermer në raport me ata që kanë ofrua deri tash.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: z. Mehani kështu trego që ki personale me drejtorin ti e shpërfaqe atë, na kem tu fol për alternativa dhe politika publike, ti ke propozua transport publik po nuk e ke argumentua asnjëherë, transporti publik behet me kompani publike, me ta aprovua qeveria, dhe disa komuna janë tu pritë për këtë çështje, po qeveria nuk po e aprovona. Donatorët i kanë specifikat e veta, islamiki i ka rastet e renda sociale, dhe me duhet me ju përshtat specifikave të tyre, dhe kur të propozoni diçka propozoni me argumente.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, kryetar the së nuk kemi pas propozime nga opozita, për drejtorin e bujqësisë unë kam dhënë propozime dhe nuk i keni marr parasysh asnjëherë, si; Subvencionimi i qumështit, sera dhe këto pajisje që po jepen a keni ndonjë raport për freza që i ka dhënë sa hektar janë frezat sa ja ka ulë koston e riprodhimit të bujkut dhe kështu nuk zhvillohet bujqësia?

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Naser kur të ngritët një çështje kam dëshire me ngrit me argumente, mëm bind, jo vetëm propozim pa argument, dhe nëse është e mirë mua me ki në krah pa marr parasysh bindjeve politike, po jo fontanë dëshira propozime.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, shkojmë në votim për rend dite; Konstatojmë me (16) vota për, (9) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, (Raporton)

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025,

në vlerë 194.930.63€, Të bartën në kategoritë: Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 92,002.99€, Në nën-programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 shuma 40,000€, Në nën-programin Arsimi parashkollor, shuma prej 30,000.00€. Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 22,002.99€. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transferove shuma prej 30,000.00€. Në nën-programin Planifikim i Zhvillimit Ekonomik 48023, shuma 30,000.00€. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej 72,927.64€. Në nën-programin Planifikimi mjedisor dhe inspekcioni 66620, projektin si vijon: "Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së" kodi i projektit 52641 shuma 72,927.64€, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Fillimisht dua me adresua një rastë, familjes Bytyqi që ju ka djeg shtëpia e krejt pasuria, nuk e di çka keni ndërmarr, po kisha propozua nëse është e mundur, dhe do duhej me qenë e mundur, që një pjesë e këtyre mjeteve me ju adresua asaj familje, sepse e kemi obligim edhe me ligj edhe obligim moral si institucion po edhe shoqëror me ju përgjigj. Unë mendoj ish kanë dashtë një 15mijë euro me ja nda asaj familje, kisha propozua si ide, unë konsultova edhe ligjin me kanë korrekt në aspektin ligjor, ligji për zjarrin neni 15 thotë: kur një fatkeqësi natyrore, niveli lokal fillimisht do të dislokoj njësit dhe resurset e tyre vetanake, kur shkalla e fatkeqësisë dhe rrezikut tejkalon kapacitetet e njësisë për shërbime emergjente dhe resurset vetanake të nivelit lokal apo ato kur nuk mund të sigurojnë nga niveli lokal atëherë i siguron shteti, pra e keni një bazë ligjore që e kërkon ndërhyrjen e nivelit lokal. Në anën tjetër neni 37 thotë: Niveli lokal është përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e tij, paragrafi 2.9 furnizimin me resurse të domosdoshme për akomodim emergjent në rastë të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Pra nëse komuna nuk mundet me bë, pra e ka për detyrë me përgatite një raport bindës nivelit qendror që kjo i tejkalon mundësit e saj për me financua. I kam disa çështje për këtë bartje sepse shpjegimi është shumë i mangët po me intereson së cili drejtor veç e veç me na sqarua përse po i duhen këto mjete; sidomos të barnat esenciale, me sa e di unë barnat esenciale i siguron niveli qendror, përse ka dal nevoja për barna esenciale? Tani të arsimi parashkollor për çfarë artikuj të nevojshme behet fjalë? Dhe qysh kanë ndikua vendimet gjyqësore të lista esenciale të barnave kur ajo nuk varet prej nivelit komunal, a kanë sqarim?

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: z. Mehani ma citoj ligjin, dhe kur ma citon ligjin mos ma cito me shkëputje rasti i familjes Bytyqi brenda 3-4 ore vet unë kam qenë prezent, dhe na si komunë i kemi përfundua detyrat tona i kemi dislokua mjete, i kemi furnizua me ushqim dhe gjera tjera emergjente, dhe DSHP, e ka krye raportin me sektorin e emergjencave dhe përmes AME-së qeveris e tash qeveria duhet ti bëjë hapat në këtë drejtim, dhe pjesën e vetë komuna e ka krye, dhe shpresoj që qeveria këtë rastë ta marr me seriozitet, jo si rastin e vërshimeve se gjitha lendet janë në pritje të bizneseve, bujqve dhe infrastruktura publike që nuk janë përkrah fare. Të ndarjet, kemi të bëjë me kontratën kolektive, kontrata kolektive është e nënshkruar nga autoritetet qendrore e që barra ja ka lan krejt komunave, dhe përmbartuesi krejt mjetet na ka marr, dhe nuk po kemi mjete me ble sene elementare dhe tash po i bartim do mjete nga këto kategori.

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Sa i përket kësaj bartje, të arsyetimi të fjala e fundit e kam dhënë sqarimin, të mallra dhe shërbime gjatë vitit aktual janë shpenzua me vendime gjyqësore përmbartimore 223mijë€, nga këto 77mijë€, janë marrë në shëndetësinë primare, ndërsa të arsimi 57mijë€.

Kryesuesja; fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: z. Nura çështja është të familja Bytyqi, a ki gatishmëri me i ndihmuar asaj familje, sepse i ki do mundësi e po gjanë arsye të vërshimet, dhe e dinë së krejt ekonomit familjare janë pagua, dhe vetë ki nënshkrua me ministrin për infrastrukturë rrugore me Hysni Durmishin, kush nuk u pagua ku ju keni fry shumë. Kontrata kolektive është përgjegjësi e nivelit qendror, dhe ajo kontratë është nënshkrua prej dikujt që ju e përfaqësoni prej subjektit të juaj politik, dhe qysh po thonë ju këtu, na nuk jena me i zbatua politikat e juaja se neve na ka dhënë qytetari zotimet e juve, edhe na niveli qendror nuk po jena me i zbatua ato vendime-zotime që i keni bërë ju. Sa i përket sqarimeve të drejtorit të financave është sqarim shumë skandaloz, po thua i marr paret i adresoj ose i arsyetoj për barna esenciale edhe po thua i përdori për diçka tjetër, nuk është mënyre qysh funksionon, një far forme është abuzim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Po me vjen mirë që erdhe në një vlerësim që the skandaloz, sa i përket arsyetimit të mallrave dhe shërbimeve duhet me kuptua mallra dhe shërbime se paku 120 nen kodë janë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë pagua dhe ne arsyetim nuk mundem me i shti 120 nen kodë dhe i kam përmend dy me të rëndësishme që duhet me u furnizua.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, shkojmë në votim; Konstatojmë me (16) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës,

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj,

Musa Fazliu-IDEAL: Pyetje 1. Për drejtorin e inspektoratit; A ka mundësi që të bëhet kërkesë nga ju për vendosjen e semaforëve ose një rreth rrotullim në rrugën Tal Sherif Miftari në hyrje të fshatit Klinë e Poshtme sepse po ndodhin shumë aksidente e se fundi kemi aksident me fatalitet? 2. Për drejtorin e urbanizmit; A ka mundësi të vendosen pusetat në gypat e kanalizimit në mes të Klinës së Mesme dhe Klinës së Poshtme dhe tjetra pusët e cila gjendet në një degëzim ku si pasojë e mos vendosjes së këtyre pusetave ekziston mundësia që të bllokohen mbi 2km?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Ajo pjesë është kompetencë e nivelit qendror për semaforë në atë rrugë, në projekt kanë qenë semaforë dhe fatkeqësisht nuk janë vendosur, dhe kërkesën që ma ke sjell me rekomandë e kam përcjell për ministri, dhe po presim përgjigje. Ki drejt për puseta ka mu marr me këtë çështje.

Afrim Kabashi-NSD: 1. Për Drejtorin për Administratë, Hamit Geci: a) Pse behet pagesa prej 50€ për regjistrimin e vdekjes. A është me ligje i përcaktuar prej pas lufte, a vien ky ligj nga viti 2015 apo para vitit 2015, Dhe a është ky ligj vetëm në komunën tonë apo është në fuqi në tere Kosovën? b) Tani jemi në Pragë të pushimeve verore, e mërgimtarët vijnë në pushime, ku shumica prej tyre kërkojnë shërbime administrative e konkretisht nga gjendja civile për të u pajisur me dokumente e tyre personale, A jeni të përgatitur për fluksin e tyre, apo keni ndonjë sportel të veçante për kërkesat e tyre në gjendjen civile? 2. Për Drejtorin e Urbanizmit, Driton Mula: Drejtor a parashihni për vazhdimin e punimeve në projektin për trajtimin e ujërave te zeza në fshatin Dashefc, konkretisht tek lagjet Beqiri dhe Rexhepi? 3. Për Drejtorin për Arsim, Kastriot Duraku: Drejtor interesimi i banoreve te fshatit Polac është lidhur me projektin e paralajmëruar dhe mjaftë te përfolur me herët lidhur me çerdhen e fëmijëve, A kemi ndonjë informatë nga ana e juaj, a pritet të realizohet ky projekt mjaft i rëndësishëm, apo ku është problemi i mos realizimit?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtorit i DA-së, Hamit Geci: Fjala përshëndetëse, pagesa prej 50€ për regjistrimin e të vdekurve është në bazë të ligjit për gjendje civile i cili është i miratuar në vitin 2011, në qoftë se nuk behet regjistrimi i të vdekurit në afat prej 30 ditëve atëherë gjobitesh prej 50 deri 100€ në bazë të ligjit, po si komunë na e kemi rregulloren për taksa që jemi shkuar në minimum prej 50€, dhe kjo shume vlen në ter. Kosovës. Për fluksin e mërgimtareve na jemi të përgatitur.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Sa i përket projektit për ujëra të zeza në Dashecit, na e dimë që e kemi përfunduar para dy viteve, po nëse është qysh po tua ka me u interesua. Sa i përket çerdhes në Polac, i kemi dërguar kërkesë ministres me të gjitha dokumentacionet përcjellës, po diçka konkrete ende nuk kemi në këtë aspekt.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetje për Drejtorin e DKA-së, z. Kastriot Dutaku- I nderuar Drejtor, Ju lutemi, a mund të na përgjigjeni në pyetjen në vijim: Me cilat kritere e keni bërë emërimin e zëvendës-drejtoreshës në shkollën e re fillore në Skenderaj, znj. Rreszarta Hasani-Ibrahimi?

Pyetje për Kryetarin e Komunës së Skenderajt, z.Fadil Nura: Z. Kryetar, A mund të na informoni se sa i keni përkrahur shoqatat e dala nga lufta në komunën e Skenderajt gjatë viteve 2023 dhe 2024? Konkretisht, cilat shoqata janë mbështetur dhe në çfarë forme është realizuar kjo përkrahje (financiare, logjistike, përmes projekteve të veçanta, etj.

I nderuar Kryetar, Shoqata e Pensionistëve të TMK-së dhe FSK-së "ELITA", dega në Skenderaj, ka paraqitur disa herë kërkesa për sigurimin e një zyre për punë, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare nga Komuna.

A mund të na informoni nëse Komuna ka në plan të ndajë një hapësirë zyrtare për këtë shoqatë dhe kur mund të pritët një vendim apo përgjigje konkrete në lidhje me këtë çështje?

Pyetje për Drejtor e urbanizimit z.Driton Mula: Kemi një pyetje në lidhje me projektet infrastrukturore në zonën tonë. A keni mundësi të na informoni nëse ka një datë të saktë se kur pritët të fillojë projekti i ujit në fshatrat Kryshec dhe Marine?


Gjithashtu, a ekziston ndonjë projekt i paraparë për kanalizimin në lagjen Kuqica të fshatit Marine? Çdo informacion do të ishte shumë i mirëpritur për ne si banorë të zonës.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Sa i përket emërimin të zv. drejtoreshës në shkollën e re është kanë e nevojshme më bë një zv. drejtoresh në atë shkollë, dhe si ZKA, kam drejtë emërimin e përkohshme për 6 muaj deri në zgjedhjen e procedurave përmes konkursit, kam pas kërkesë prej DKA-së për me bë këtë emërtim. Shoqatat e dalura nga lufta, sipas mundësive përpjekja është me ju ndihmua, sepse kanë shpenzime si derivate, lule, drekat e tyre që mua me faturohen si zyre kur e kanë ndonjë eventë e marr për sipër si komunë. Unë e kam pasur në zyre kryetarin e shoqatës dega në Skenderaj kam bisedua, i kam thënë bima kërkesën me nënshkrime dhe kemi me shikua për me jave sigurua një zyre në shtëpinë e kulturës, po në atë kohe shtëpia e kulturës u kanë tu u rinovua dhe nuk kam mundur me ju përgjigj pozitivisht me kohe dhe i kam lënë me pritë. Ujë në fshatin Kryshec dhe Marinë duhet me u trajtua, po jemi vonua sipas planifikimeve dhe objektivave që i kemi pas, dhe se shpejti kanë me përfundua. Kanalizimi në Marinë kemi me trajtua se pari pjesën të livadhet të varrezat sepse aty kundërmon erë e rend, pastaj do ti trajtojmë edhe pjesët tjera.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit

